



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



04.10.2022

REPUBLICA KOSOVA STACIONI I AUTOBUSAVE SUHAREKE  
REPUBLICA KOSOVA STACIONI I AUTOBUSAVE SUVA REKA

NPL "STACIONI I AUTOBUSAVE"

SH.A. SUHAREKE RECEIVED

Nënska org. Qend. Joshtnica	Numri Broj	Shiroja Pritog Appendix	Vlerë Vrednost Value
01	111	66023	2

**KOMUNA E SUHAREKËS**  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

## **KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE**

Në mbështetje të nenit 16 lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të shpallur në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-31/2008”, e konform nenit 9 dhe 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të shpallur në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-13/2012, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-009, të shpallur në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-10/2015 Komisioni Komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Suharekë, shpall:

### **K O N K U R S**

**Për 1 (një) pozitë Drejtorë/e të Ndërmarrjes Publike Lokale, “Stacioni i Autobusëve”  
në Suharekë**

### **KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE**

Një kandidat/e për t'u zgjedhur Drejtor/e i/e ndërmarrjes publike lokale, “Stacioni i Autobusëve” në Suharekë, duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 17, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, dhe neni 9 dhe 13, të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-009, të shpallur në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-10/2015, si vijon:

- Të ketë kualifikim superior në fushat e poshtëshënuara:
  - në administrim të biznesit;
  - financa korporative;
  - financa;
  - menaxhim të thesarit;
  - ekonomi-menaxhment
  - banka;
  - konsulencë në biznes;
  - industri ose
  - të ketë qenë së paku për 5 vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjeter që ndërlidhet me veprimitarinë afariste të Ndërmarrjeve Publike Lokale.



## **KUSHTET:**

Një person ka të drejtë të shërbejë si Drejtor/e i/e ndërmarrjes publike lokale, "Stacioni i Autobusëve" në Suharekë, nëse:

- Nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- Nuk ka shkelur kodin etik apo standartet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgjënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrjet Publike ku kandidati aplikon.

**Kandidati/ja nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Lokale, nëse:**

- Aktualisht është zyrtar (*në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike*), menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse, ose cilësdo nga filialet e saj;
- Ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (*përvjet si konsumator individual i shërbimeve të Ndërmarrjeve Publike*) me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga Ndërmarrja Publike përkatëse ose cilado nga filialet e saj (*përvjet honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike*), ose është anëtar në skemën pensionale të Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj;
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- Është i afërm i shkallës së tretë (*sic është konstatuar në përpunhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike*) i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategoritë e sipërpermendura.
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me Ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (*i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të drejtave të votimit*), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurojnë me Ndërmarrjen;
- Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavatur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe Ndërmarrjeve Publike.



## INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Lokale duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvjoes së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim, me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgjëneshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëherëshëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike në të cilën konkuron kandidati/ja dhe të dorëzohen në Zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Lokale, “Stacioni i Autobusëve” në Suharekë me seli në Rr. “Br. 123”.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.


Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 029/271-160.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i Drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale do të bëhet në bazë të nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe nenit 12 Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-009, të shpallur në “Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-10/2015.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit nga popullata shumicë dhe jo-shumicë dhe te interesuarit që do të përfaqësojnë interesat e Komunës ku NPL vepron, që të aplikojnë në konkursin për Drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Suharekë.

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor dhe në web faqen zyrtare të Ndërmarrjes (prej datës 04 tetor 2022 deri më datën 04 nëntor 2022).

Komisioni Komunal i Aksionarëve  
  
Reshat SELIMAJ-Kryesues

